

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
DeBORA'S Clean SH.P.K.**

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

**NENI 1**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**DeBORA'S Clean**" sh.p.k, krijohet nga ortaket e vetem

**Zj.Blerina Gjyriqi** e datëlindjes 01.05.1984, lindur ne Bajram Curri, madhor e me zotesi juridike e per te vepruar mbajtes i letërnjoftimit me nr personal Nr. I45501095H,e cila do te ushtroje aktivitetin e saj juridik.

**NENI 2**

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne baze te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", si dhe neneit 32 te ligjit 9723 date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Biznesit".

Kjo shoqeri fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Biznesit Tirane.

**NENI 3**

**Emertimi i shoqerise**

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "**DeBORA'S Clean**" sh.p.k Kjo shoqeri e ketij lloji do te perballoje humbjet e saj deri ne vleren e kapitalit te saj themeltar te paraqitur ne kete statut.

**NENI 4**

**Selia e shoqerise**

Selia e shoqerise do te jete ne adrese; Tirane, Tirane, TIRANE, Rruga "Sotir Caci" Tirane, pall. Jon, kati 1, zyra 2.



Shoqeria mund te kete filjale dhe perfaqesi te saj edhe ne rrethe te tjera te Republikes se Shqiperise dhe jashte teritorit te saj.

#### **NENI 5** **Objekti i Veprimtarise**

Do te jete :

Aktivitetet e lidhura me sherbim pastrimi ne pergjithesi si: Pastrime te ambienteve te perbashketa, pastrime per entet publike, private, vendase dhe te huaj, banka, qendra tregtare, spitale, shkolla, konvikte, hotele, restorante, kinema etj.

Veprimtari ne fushen e pastrimit, dezinfektimit, deratizimit, te ambienteve te brendshme dhe te jashtme per entet publike dhe private.

Pastrime larje,sterilizime, dezinfektime,hekurosje,paketime,dhe administrime te ketyre veprimtarive per persona fizik, juridik, ente publike etj.

Pastrime te jashtme dhe te brendshme ambienteve si banesa private,zyra, godina ,kopeshte, lulishte, pastrime ne lartesi dhe ne kate te nendheshme.

Sherbime lavanderi dhe pastrim kimik.

#### **NENI 6** **Kohe zgjatja e shoqerise**

Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj **pa afat**. Ajo mund te perfundoje veprimtarine e saj perpara ketij afati ne rastet e prishjes ose te likuidimit te shoqerise

#### **NENI 7** **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte caktuar ne shumen 100.000 leke , kapital i zoteruar nga ortakët e shoqerise si me poshte:

- **Blerina Gjyriqi** zoteron 100% te kapitalit nje kuote me vlere 100.000
- Lloji i kontributit: në para; vlere e kontributit: 100.000 LEK; numri i kuotave 1 kuote, vlere nominale e kuotes e barabarte me 100.000

#### **NENI 8**

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem ne rruge trashegimie.

Me vullnetin e ortakeve kapitali themeltar mund te transferohet edhe personave te trete.

#### **NENI 9**

Ortakët e cilet jane themelues te kesaj shoqerie me vullnetin e tyre mund te shtojne kapitalin themeltar te shoqerise ne çdo periudhe qe ata e shohin te nevojshme.



## NENI 10

Administrator dhe ortak te shoqerise jane vete themeluesit **Blerina Gjyriqi** per 5 vjet.

## NENI 11

**Asambleja e Ortakeve ka te drejte :**

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimet e statutit .
- Emerimi dhe shkarkimi i administratoreve.
- Emerimi e shkarkimi i likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimi i shperblimeve per administratoret, likujduesit dhe eksperteve kontabel te autorizuar.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Ceshtje te tjera te parashikuara ne ligj apo ne statut.

## NENI 12

**( Ne rast emerimi te Administratorit tjeter te kesaj shoqerie)**

**Administratori do te kete keto te drejta e detyrime ;**

- Te kryej te gjitha veprimet administrative te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjitheshme ( Ortakeve te shoqerise)
- Te perfaqesoje shoqerine tregtare.
- Te kujdeset per mirembajtjen e sakte e te rregullut te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise.
- Te pregatise dhe te nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asambleve se pergjitheshme per miratim.
- Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- Kryen regjistrimin dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin Per Qendren Kombetare te Regjistrimit.

*Blerina Gjyriqi*

- Raporton para asamblese se pergjitheshme ne lidhje me zbatimin e polikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- Kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

#### NENI 13

Per perfaqesimin e shoqerise perpara organeve shteterore administrative dhe gjyqesore ose te treteve, shoqeria prezantohet nga ortaket e shoqerise.

#### NENI 14

Shoqeria ka vulen e vet. Forma dhe teksti percaktohen nga Asambleja e Ortakeve ne kete rast (ortaket).

#### NENI 15

##### **Bilanci dhe te ardhurat**

Veprimet ekonomike dhe financiare fillojne me 1 Janar dhe mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti. Asambleja e Pergjitheshme cakton nje ekspert te autorizuar i cili ben bilancin e vitit ushtrimor paraardhes me te ardhurat, fitimet dhe humbjet, te formuluar keto konforme ligjit nr. 9228 dt.29.04.2004 " Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Bilanci miratohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve e shoqerise. Ai depozitohet ne zyren tatimore sipas afatit ligjor.

#### NENI 16

Eshte kompetence e Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise (Ortakve te Vetem) te vendose per krijimin e fondeve nga te ardhurat neto si dhe perdorimin e tyre sipas nevojave te tij.

#### NENI 17

Kapitali i shoqerise depozitohet ne llogarine e shoqerise prane nje banke private ose shteterore vendase ose te huaj qe vepron ne territorin e Shqiperise. Shoqeria mund te çele llogari bankare ne leke ose ne valute ne nje banke tjeter private apo shteterore vendase ose te huaj, brenda dhe jashte vendit.

#### NENI 18

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie i perket teresisht ortakut te vetem te saj. Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet me kapitalin e saj.

#### NENI 19

##### **Shperberja**

Duke qene se ne çdo kohe per motive te ndryshme shoqeria mund te ndodhet perballe shperberjes, me vendim te ortakut te vetem vendoset per menyren e likuidimit te saj, ne baze te ligjeve ne fuqi.

Likujdimi i shoqerise mund te behet sipas rasteve te parashikuara ne ligji.

**NENI 20**

Per çeshtje qe nuk parashikohen e rregullohen nga ky statut, vlejne dispozitat 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", te ligjit 9723 date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", si dhe aktet e tjera ligjore qe rregullojne kete veprimtari.

**NENI 21**

Statuti u perpilua ne kater kopje me fuqi te njejte ligjore te cilat do te sherbejne per tu administruar ne organet kompetente tatimore dhe gjyqesore dhe kopjet e tjera mbeten ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**ORTAKU I SHOQERISE  
DeBORA'S Clean**

**Blerina GJYRIGI**



16.06.2021